



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 132/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Novobërdë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Novobërdë, lidhur me ndërrimin e dhe largimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Novobërdë.**

## A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Novobërdë, në të cilin thekson se KKZ në Komunën e Novobërdës i udhëhequr nga zyrtari i saj Selim Mehmeti është duke bërë shkelje ligjore për procesin e komisionerëve duke vendosur rregulla diskriminuese për koalicionin PDK-AAK-NISMA për faktin se koalicioni i subjekteve politike PDK-AAK-NISMA me datën 27.05.2017 ka dorëzuar lista e nominimeve për komisionar dhe caktimin e tyre se ne cilat vendvotime do të jene ne shërbim te procesit zgjedhor. Sipas parashtruesit te apeli zyrtari i KKZ-së Selim Mehmeti pa asnjë konsullt me subjektet e koalicionit ka bere largimin e tyre nga 15 vendvotime dhe ka vendosur vetëm ne disa vendvotime komisioneret e koalicionit duke përcaktuar në një vendvotim nga dy e tre komisionar te koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe lënë bosh te vendvotimeve te përfaqësuar nga komisioneret e koalicionit PDK-AAK-NISMA. Sipas parashtruesit te apelit zyrtari i KKZ-së Selim Mehmeti ka kërcënuar me vrasje anëtarin e KKZ-së nga subjekti politik AAK

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj KQZ-në me datën 07.06.2017, për apelin që është bërë.

PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja brenda afatit të caktuar, në të cilën theksohet se në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2017, nr. 827/2017, KKZ-ja ka miratuar përbërjen e

kryesuesve, anëtarëve dhe anëtarëve rezervë të Këshillave të Vendvotimeve për Komunën e Novobërdës. Po ashtu theksohet se kryesuesi i KKZ-së në Novobërdë, ka njoftuar të gjitha subjektet politike dhe AAK në Novobërdë e cila është pjesë e koalicionit PDK-AAK-NISMA që ti përmbahet formulës përkatëse të miratuar nga KQZ me datën 31.05.2017.

Sipas konfirmimit përmes shkresës sqaruese të kryesuesit të KKZ-së në Novobërdë të datës 08.06.2017 me nr 1015/2017 të dorëzuar në Sekretariat thekson se subjekti politik AAK nuk e ka respektuar formulën e dorëzuar nga KKZ-ja dhe të miratuar, duke ndërruar listën e vendeve të anëtarëve të KVV-ve. Këto propozime kanë qenë në kundërshtim me vendimin e KQZ-së dhe për këtë arsye KKZ-j ane Novobërdë nuk ka mundur të procedon në KQZ dhe se KKZ ka dorëzuar në KQZ listën me nominimet për anëtar të KVV konform formulës së KQZ për të cilën ka bashkangjitur si dëshmi përbërjen e kryesuesve , anëtarëve dhe anëtarëve rezervë të KVV për Komunën e Novobërdës të miratuar nga KQZ.

PZAP-i gjeti se apeli është i **palejuar**:

Parashtruesi i ankesës nga subjekti politik AAK, pretendon se në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore është bërë ndërrimi i vendeve të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, nga ana e KKZ-së dhe KQZ-së në Novobërd.

Paneli, vlerëson se apeli i parashtruar është i palejuar ngase PZAP, vendos sipas nenit 122 të LZP-së, vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së, e jo ndaj vendimeve të KKZ-ve ashtu si ankuesi ka parashtruar në apel me të cilat pretendime e kundërshton vendimin e ndërrimit emra të KVV-ve në listë nga ana e KKZ-së në Novobërdë. Ndërsa lidhur me kërcënimet e pretenduara PZAP-rastin do ta përcjdh për procedim të më tutjeshëm në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 132/2017 më datën 09.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Rafet Haxhaj



#### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*